

Vendim nr. 157 datë 10.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Marjana Semini, Anëtare
Sandër Beci, Anëtar

në datën 10.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (L) 2023 të Regjistrit
Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **LEVEN SHAHAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 61, datë 06.04.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 69, datë 09.06.2017 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2022-1620, datë 15.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rigjykim.**

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 71, 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi rezulton se ka nënshkruar një kontratë pune me shtetasin A.B., administrator i shoqërisë “Billa General Works” sh.p.k., i cili ushtron veprimtari tregtare në fushën e ndërtimit. Ky subjekt tregtar rezulton se kishte lidhur kontratë për ndërtimin e një kompleksi me autoritetet e shtetit të Guinesë Ekuatoriale (Afrikë), vend në të cilin do kryhej dhe aktiviteti, për të cilin ishte lidhur kontrata me kërkuesin. Gjithashtu, rezulton se ndërmjet kërkuesit dhe administratorit A.K. kanë lindur mosmarrëveshje në vendin e punës, madje dhe konfrontim fizik, sipas deklaramit të disa personave. Për rrjedhojë, kërkuesi ka lënë punën dhe ka kërkuar të kthehet në Shqipëri.

2. Pas kthimit në Shqipëri kërkuesi ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit A.B., pasi sipas tij, ky i fundit kishte kryer veprën penale “Trafikimi i personave” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal (KP), si dhe veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 89 të KP-së. Në datën 09.12.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit A.B. Ndaj këtij vendimi të prokurorisë është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe janë zhvilluar disa procese gjyqësore. Në përfundim të këtyre proceseve gjyqësore, Prokuroria, pasi ka kryer detyrat e lëna nga gjykatat, në datën 23.04.2015 ka vendosur: “Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 85 të vitit 2013, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale.”.

3. Mbi ankimin e kërkuesit Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 61, datë 06.04.2017, ka vendosur rrëzimin e ankimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 69, datë 09.06.2017, ndërsa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1620, datë 15.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga kërkuesi, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

4. Në datën 15.04.2023 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 27.04.2023, sipas nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

- 5.1. *Procesin e rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi:*
- 5.1.1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar dhe i gabuar. Nuk është e vërtetë që medikamentet ia ka ofruar shoqëria për të cilën ai punonte. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është lajmëruar t'i blinte vetë ato. Sipas tij, aktiviteti i shoqërisë ka filluar që në muajin korrik të vitit 2011, ndërkohë që rezulton e provuar se shoqëria është regjistruar në datën 18.06.2012, pra një vit më vonë. Gjithashtu, shoqëria nuk ka paguar sigurimet shoqërore dhe se kontrata e punës për të punuar në Afrikë duhej të bëhej me akt noterial, pasi nevojitet vizë pune dhe duhej të paguheshin sigurimet shoqërore. Nga ana e prokurorisë nuk është bërë verifikim nëse janë të vërteta deklaratimet e bëra nga shtetasit B.R., E.L., S.T. dhe Z.T. Arsyetimi i kësaj gjykate se punonjësit ishin lajmëruar për riskun e sëmundjes së malaries dhe ishin këshilluar për profilaksinë e saj, nuk qëndron, pasi punonjësit jo vetëm që nuk janë lajmëruar nga firma, por edhe kur janë prekur nga malaria nuk janë dërguar në qendrat shëndetësore.
- 5.1.2. Arsyetimi i gjykatës së apelit është i njëjtë me atë gjykatës së shkallës së parë dhe se prokuroria nuk ka kryer të gjitha veprimet e lëna nga gjykata e apelit.
- 5.1.3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë bërë kalime procedurale dhe kanë dhënë vendimet e tyre, duke anashkaluar edhe detyrat e lëna prokurorisë për hetimin. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se në rastin konkret ndodhemi përpara zbatimit të gabuar të ligjit procedural. Në këtë proces është cenuar haptazi procesi i rregullt ligjor, pasi vendimet janë marrë pa u kryer një hetim i plotë.
- 5.2. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor, ose poshtërues, pasi kërkuesi është trajtuar në mënyrë çnjerëzore nga shtetasi A.B. Ky i fundit nuk i ka siguruar atij të gjitha nevojat e domosdoshme mjekësore dhe kushtet e tjera të jetesës. Për këtë arsye, ai është detyruar të largohej në fshehtësi prej vendit të punës, pasi ishte e vetmja mënyrë që të shpëtonte. Nga ngjarja e ndodhur kërkuesit i kanë ardhur pasoja negative reale të drejtpërdrejta.*

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kolegji çmon se kërkesi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

8. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individ i pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkojë vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi i ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë plotësohet edhe ky kriter.

10. Kërkesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar në këtë Gjykatë, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 15.12.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 14.04.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji rithekson qëndrimin e mbajtur nga jurisprudenca konstante e Gjykatës, sipas së cilës interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ndërhyr vetëm kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më sipër, duke iu referuar rastit konkret, Kolegji vëren se, në përgjithësi, të gjitha argumentet e sjella nga kërkuesi për cenimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme që, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

13. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e tij për trajtimin çnjerëzor, Kolegji konstaton se edhe pse kërkuesi ka barrën e provës në këtë proces, ai nuk ka arritur të paraqesë argumente kushtetuese dhe të provojë cenimin e pretenduar të dispozitave kushtetuese nga vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe gjykatat i kanë kushtuar rëndësinë e duhur pretendimit të kërkuesit për trajtimin çnjerëzor, duke kryer të gjitha veprimet hetimore për hetimin tij, siç janë pyetja e dëshmitarëve, thirrja e ekspertëve, shqyrtimi i dokumenteve e të tjera dhe, në përfundim, kanë vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me trajtim çnjerëzor, pasi nga punëdhënësi janë respektuar të gjitha detyrimet e parashikuara në kontratën e punës, përfshirë këtu kushtet e punës, orarin e punës, mënyrën e pagesës, shpenzimet e udhëtimit, vaksinimin, si dhe pajisjen me medikamentet e nevojshme. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit të parashtruara përpara kësaj Gjykate nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, pasi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

14. Si përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.